



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:256848
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847900

KPPP.nr.1434/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A, me NRB: 70325399, me seli në Prishtinë, rruga “Nëna Terezë” nr.36, kundër debitorit “LOKAL Haxhimet Rexha”, me seli në Ferizaj Rr.”Ramadan Salihu” nr.1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1341/18 të datës 20.12.2018, të Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “LOKAL Haxhimet Rexha”, me seli në Ferizaj, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.1341/18 i datës 20.12.2018, i Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.1343/18 të datës 20.12.2018, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist DEF - ... të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’ia paguajë kreditorit shumën prej 1,697.23 €, për periudhën kohore nga data 06.04.2005 deri më datë 20.03.2013, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm. Nëse debitori brenda afatit nuk e përmbush detyrimin, përmbartimi të realizohet përmes ndalimit të

mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogarinë rrjedhëse, ose përmes regjistrimit, vlerësimit, sekuestrimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme të debitorit të cilat ndodhen në posedim të tij deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke kërkuar që prapësimi të aprovohet dhe urdhri për përmbartim të anulohet si i pa bazuar. Në seancën dëgjimore ka deklaruar se mbetet në tërësi si në deklaratimet në prapësim dhe ka shtuar se në bazë të kontratës së lidhur me kreditorin e datës 24.08.2016, i ka paguar të gjitha këstet e parapara edhe me deklaratën mbi dakordimin e borxhit por që këstin e fundit ka mbetur pa e paguar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar duke kërkuar që prapësimi të refuzohet si i pa bazuar dhe urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi. Në seancën dëgjimore ka mbetur pranë kundërshtimeve si në përgjigjen në prapësim, ka shtuar se debitori ka nënshkruar kontratën për pagesën e borxhit dhe pastaj ka paguar pesë këste me qëllim të përfitimit nga dispozitat e ligjit për faljen e borxheve publike mirëpo debitori nuk e ka respektuar kontratën deri në fund dhe për shkak të mos pagesës së një kësti vlere e faljes së borxhit i është rikthyer. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet dhe urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin PPP.nr.23/20 të datës 22.09.2020, ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin përmbartimor P.nr.1341/18, të datës 20.12.2018, dhe pjesërisht e ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor.

Kreditori me datë 02.10.2020, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, konstatim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit, të anulohet aktvendimi dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.5340/20 të datës 19.10.2021, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr.23/20 të datës

22.09.2020, të Gjykata Themelore në Ferizaj dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundojë në tërësi për shkaqet si në vijim:

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit dhe kreditorit, dhe të kontratës për pagesën e borxhit e datës 24.08.2016, me numër 30995 si dhe deklaratës mbi dakordimin e borxhi e datës 24.08.2016, konstatohet se debitori me kreditorin kane lidhur kontratën që me pagesën e borxhit nga janari i vitit 2009 në shumë prej 177.44 euro, debitori të përfitoj faljen e borxhit prej 1,669.79 euro, dhe se në bazë të deklaratës mbi dakordimin e borxhit debitori kishte për obligim që ti paguaj pesë këste në shumë prej 30 euro ndërsa këstin e gjashtë në shumë prej 27.44 euro dhe nga ekstrakti i librave afariste i propozuar nga kreditori shihet se debitori i ka paguar gjithsejtë 5 këste përveç këstit të fundit që ka mbetur pa paguar, andaj duke e marr për bazë nenin 3 të kontratës për pagesën e borxhit del se debitori nuk ka bërë shkelje të nenit 3 të kësaj kontrate, për arsye se në neni 3 të kontratës në fjalë është parapare se: *"Ne rast se përfituesi shkakton tri vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas programit, marveshja shkëputet dhe pjesa e paguar e borxhit nëse ka fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet duke përfshirë këtu edhe gjitha ndëshkimet"*, dhe rrjedhimisht në këtë rast debitori siç është konstatuar edhe më larte nuk i ka shkakuar tri vonesa të njëpasnjëshme por vetëm një dhe për shkak të kësaj vonese të pagesës së këstit për shumën e borxhit prej 27.44 euro, kreditori nuk ka pasur të drejtë që të kërkojë nga përmbartuesi privat realizimin e borxhit në shumë prej 1,697.23 euro, por vetëm shumën e borxhit prej 27.44 euro. Andaj duke i marr parasysh faktet e cekura debitori edhe pse është vonuar një këst pa e paguar sipas kontratës për pagesën e borxhit dhe deklaratës mbi dakordimin e borxhit, i njëjti ka përfituar nga falja e borxhit në shumë prej 1,669.79 euro.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, janë përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat sipas ekstraktit nga librat afariste, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të nenit 29, par.1 nën par 1.2 të LPP-së, për faktin se përmban të meta në raport me objektin e detyrimit, përkatësisht i njëjti ekstrakt nuk pasqyron vetëm borxhin e debitorit si rezultat i furnizimit me energji elektrike dhe kjo për faktin që në ekstraktin afarist DFE – ..., rezulton se debitori është ngarkuar edhe me detyrimin për të cilin me kontratën për pagesën e borxhit e datës 24.08.2016, me numër 30995, ka përfituar faljen e borxhit prej 1,669.79 euro.

Andaj, duke qenë se me dispozitat nga neni 29, par.1 nën par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar shprehimisht se dokumente të besueshëm janë ekstraktet të cilat për objekt detyrimi kanë borxhin e krijuar si rezultat i furnizimit me energji elektrike, ndërsa kreditori në ekstrakt ka faturuar edhe borxhin për të cilin është falur sipas kontratës së datës 24.08.2016, si dhe duke marr parasysh faktin që kreditori përmes këtij ekstrakti ka kërkuar edhe përmbushjen borxhit të falur, gjykata vlerëson se në rastin konkret ekstrakti DFE – ..., nuk përbën dokument të besueshëm dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbaruesmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe pretendimet tjera të palëve në procedurë, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohen në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1434/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.